



VENDIM

Nr. 157, Datë 06.10.2016

MBI

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “ENERGY MARKET ALBANIA” SH.P.K.
NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “d” dhe 39 pika 3 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1 gërma ‘e’ dhe 13 të “Rregullores për Proçedurat dhe Afatet per Dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Liçensave në Sektorin e Energjise Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.10.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energy Market Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie;

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregullore për Proçedurat dhe Afatet per Dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Liçensave në Sektorin e Energjise Elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërma ‘a’, ‘b’ dhe ‘c’) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërma ‘a’, ‘b’, ‘c’, ‘d’, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Të dhënat specifike të liçensës (neni 9, pikat 4/8 gërma “a”, “b”, “c” dhe “d”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë “Energy Market Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5 - vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI